# PROCES VERBAL

Mbajtur sot me datë: 31.10.2022, ora 14:00 në Njësinë Administrative Klos, për hartimin e projekt- buxhetit 2023 dhe Paketës Fiskale 2023.

Morrin pjesë: Kryetari i Bashkisë, Kryetarja e Këshillit Bashkiak, Nënkryetarja e Bashkisë, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike & shërbimeve financiare, Përgjegjësja e Sektorit të financës, përfaqesues të biznesit, banorë të Njësisë administrative & Administratori i Nj. Adm. Klos.

Hap mbledhjen Kryetari i Bashkisë & tregon arsyen për të cilën janë mbledhur, për të marrë kërkesa dhe mendime lidhur me hartimin e buxhetit, paketës fiskale 2023 & PBA 2023-2025.

Ai shpjegon që buxheti i vitit 2023 është i kushtëzuar, duke qenë se rruga Pleshë - Patin - Cerujë është parashikuar të behet për 3 vitë 2022-2024.

Tregon që për vitin 2022 janë shtruar 1,8 km rrugë me asfalt.

Tregon që lajmi mirë për 8-fshatrat (Bel, Unjste, Fullqet, Dars, Fshat, Klos-katund, Plani i Bardhë e Shëngjun) është që është hedhur në prokurim Ujësjellësi i Përroit të Lopës & Gurrave të Ketës.

Kryetari shpjegon që do shikojë mundësinë që qyteti të ketë 24h në ditë ujë, në mënyrë që të hiqen cisternat.

Në lidhje me KUZ e lagjes Riza Beg Çela tregon që për pak ditë do lidhet kontrata e do vijojë puna.

Marrin fjalën pjesëmarrësit:

- Agim Alla, i cili paraqet si kërkesë fasadat e pallateve. Kryetari e sqaron që fasadat janë të domosdoshme, por që kanë kosto më të lartë pasi duhet marrë parasysh & eficenca e energjisë.

Gjithashtu kërkesa e banorëve është për tregun e përgjithshëm & për tregun e gjësë së gjallë.

Kryetari kërkon mendimin nga pjesëmarrësit për vendin ku ato mendojnë që të zhvillohet tregu.

Kryetarja e Këshillit: Ka kërkesë për çerdhen si një domosdoshmëri e vazhdueshme.

Kryetari shpjegon që ka berë kërkesë që të lirohet vendi ku ka qenë çerdhja e aktualisht është stacioni i policisë ka kërkesë që policia të zhvendoset diku tjetër.

Ilir Dedolli: Ka kërkesë për filial banke.

Kryetari shpjegon që ka bërë kërkesa të vazhdueshme si për filial banke, ashtu edhe për zyrë pune.
Ilir Hoxha ka kërkesë për një zyrë noterie.
Din Topalli pongjet kërkesë për kënd lojërash & për fushë futbolli.
Kryetari sqaron që për këndin e lojërave shumë shpejt do të lidhet kontrata e do fillojë puna, ndërsa në lidhje me fushat e futbollit tregon që është premtuar nga Kryeministri që do të nalëtohen.
Kryetari shpreh shqetësimin në lidhje me problemet e fshatit Bërshi si vaditja & rruga.
Për rrugën tregon që sh shpejt do e zgjidhë problemin duke e shtruar me rërë bituminoze.
Ilir Hoxha shpreh një mendim që për fshatin Fullqet në lidhje me vaditjen që të behet rezervuar te antena (poshtë antenës), për ta bërë digën te Rakip Çipi e poshtë.
Gjithashtu shpreh mendim që për Pleshë, Kukatin e Patin duhet ngrit diga në Balgjaj.
Ilir Hoxha ka kërkesë gjithashtu për të hapur rrugën te Kaçuli, Alstafa e Konaj.
Kryetari sqaron që ujë e Klosit e cila për shumë vite ka qenë gangrenë, më në fund është zgjidhur, ka filluar ndërtimi i saj.
Bedrije Kaçi, banore e fshatit Bejnë ka kërkesë për të lidhur pjesën e rrugës se sipërme në Bejnë.
Ylli Dedolli ka kërkesë për fond për riparimin e rrugëve aktuale që janë me asfalt, në mënyrë që të mos shkatërrohen.

**Drejtor i B. Njerëzore, Ç. Juridike dhe Sh. Financiare**

Enduina Neli

Përgjegjëse e Financës

Silvana Bala